

## **AKTI THEMELIMI**

### **SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

#### **“PAMM Studio“ Sh. p. k**

Sot, ditën e Hënë më datë 11 / 01/ 2021, unë, themeluesi i vetëm : **Sokol Shkodra**, i biri i Mehdi dhe i Engjellushe, datëlindja 11/ 05/ 1975, lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 035201655 dhe numër personal H50511139U, vendos të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, **“PAMM Studio“**, biznes i vogël, mbështetur në nenin 2 paragrafi “B” i Ligjit “Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit”, në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” për të cilën unë si Ortak i vetëm vendosa dhe për këtë qëllim hartimin dhe Aktin e Themelimit të tij, me përmbajtjen si vijon:

#### **NENI 1**

##### ***Emri***

Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet **“ PAMM Studio**  
**“**, e cila këtu më poshtë do të quhet **“Shoqëria“**.

#### **NENI 2**

##### ***Forma***

Kjo Shoqëri është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Biznes i vogël

#### **NENI 3**

##### ***Baza juridike***

Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### **NENI 4**

##### ***SELIA***

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën:  
**Rruga "Reshit Collaku", Ndertesa 24, Hyrja 2, Ap. 12, Tirane**  
Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

## **NENI 5** ***Territori***

**5.1** Shoqëria zhvillon aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj. **5.2** Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## **NENI 6** ***Objekti i veprimtarisë***

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- a. Në fushën e shërbimeve të marketingut mediatik; vizual, të printuar, dixhital dhe përmes internetit
- b. Në fushën e shërbimeve për menaxhimin dhe reklamimin e bizneseve ose produkteve të tyre
- c. Në organizimin e panairove, eventeve të ndryshme si edhe aktivitete festive dhe promovuese
- d. Në fushën e ndërmjetësimin për shitblerjen dhe qiradhënien e pasurive të patundëshme.
- e. Në fushën e ndërtimeve, rikonstruksioneve, mirëmbajtjen e godinave, banesave dhe ambjenteve të ndryshme banimi, publike ose industriale
- f. Në fushën e administrimit, pastrimit dhe mirëmbajtjen e godinave rezidenciale dhe komerciale
- g. Në çdo fushë dhe aktivitet tjetër tregtar që lejon ligji dhe përfshihet në veprimtaritë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, sh.p..k.

## **NENI 7** ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

## **NENI 8** ***Kapitali themeltar***

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100.000** (njëqindmijë) Lekë. Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i vetëm.

#### **NENI 9** **Kontributet**

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i Ortakut të Shoqërisë **“PAMM Studio”** në vlerën **100.000** (njëqindmijë) Lekë.

#### **NENI 10** **Pjesët e kapitalit themeltar**

**10.1** Kapitali themeltar është i ndarë në 1(një) pjesë plotësisht të shlyera, me vlerë nominale 100.000 (një mijë) Lekë,

**10.2** Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**10.3** Ortaku i vetëm themelues **“PAMM Studio”** zotëruar i 1(një) pjesëve me vlerë të përgjithshme 100.000 Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 11** **Administrimi**

Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i Shoqërisë me vendim të ortakut është caktuar **Z. Sokol Shkodra**. Ai ushtron këtë detyrë për një periudhë **5 vjet**.

#### **NENI 12** **Dispozita të fundit**

**12.1** Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet prej Ortakëve dhe si i tillë do të miratohet në QKB Qendra Kombëtare e Biznesit ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

**12.2** Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

**Themeluesi i**


"PAMM Studio" Sh. p. k

Sokol Stiborac

Emri,

Mbiemri,

Firma

A handwritten signature in blue ink, consisting of several loops and a long horizontal stroke at the end, positioned below the printed name and the 'Firma' label.